

UNIQA Maqedoni

Jetojmë më mire së bashku me argëtim, kulturë dhe sport

Aktivitetet e mbështetura nga UNIQA në argëtim, sport dhe kulturë janë vetëm zbulim të aktivitetit të shpërblyer nga Ministria e Shëndetësisë për përgjegjësi sociale pas aksionit të përbashkët në kompani për dhurim të gjakut në pandemi. Kur pika e gjakut vlente jetë, UNIQA ishte aty për të dhënë copëza jete për pacientët e prekur nga pandemia globale COVID-19.



Rreth UNIQA:

Shoqëria e sigurimeve UNIQA SH.A Shkup është në pronësi të kompanisë austriake të sigurimeve lider UNIQA Insurance Group. Në Maqedoni, UNIQA SH.A Shkup është një pasues ligjor dhe afarist i Sigal A.D Shkup i cili është themeluar si degë e SIGAL, Shqipëri në vitin 2004. Në tregun e sigurimeve të Maqedonisë ajo ofron produktet e saj që nga viti 2005.

Në qershor të vitit 2009, dega maqedonase e SIGAL UNIQA Insurance Group ribrendohet / ristrukturohet në UNIQA A.D Shkup dhe vazhdoi të ofrojë të gjitha format e sigurimeve të jo-jetës duke i shitur nëpërmjet punonjësve të saj në shitje dhe një rrjet të bashkëpunëtorëve të jashtëm – agjentë dhe broker.

Nga 26 maj i vitit 2011 nëpërmjet shoqërisë të posa formuar UNIQA Life Maqedoni, UNIQA hyri në tregun e sigurimit të jetës në Maqedoni." shkruhet në prezantimin zyrtar të Uniqa.

Për të realizuar këtë material ne kemi biseduar me Drejtorin ekzekutiv, Driton Azizi që të kuptojmë nga dora e parë projektet me karakter filantropik që ndihmojnë dhe janë për të përparuar shoqërinë tonë, nëpërmjet mbështetjes të vazhdueshme të kompanisë për nisma të ndryshme. Nga Uniqa na thanë se shoqërinë, përveç ndihmave tjera të vazhdueshme gjatë aktivitetit të përditshëm zyrtar, e kanë ndihmuar edhe në tre mënyra të drejtpërdrejta: Dhënia e gjakut në kohë pandemi kur të gjithë kishin nevojë për gjak; Mbështetje për projekte kulturore, ku spikat mbështetja për festivalin e muzikës kamertale "Skupi KamerFest"; dhe mbështetja e maratonës "ColorRun" gjatë muajit të kaluar në Shkup.

UNIQA Maqedoni përveç përgjegjësisë kontraktuale të realizuar nëpërmjet dëmshpërblimeve, i kushton një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale, duke kontribuar në projekte sociale, kulturore, sportive, artistike si dhe në arsim e edukim duke ndjekur parimin udhëzues të strategjisë UNIQA 3.0 "Jetojmë më mirë së bashku" u tha në takimin për realizimin e këtij materiali.



Aksioni i dhurimit të gjakut në kohë pandemie

Të vetëdijshëm se furnizimi i vazhdueshëm dhe në kohë i institucioneve shëndetësore me gjak është një parakusht shumë i rëndësishëm për funksionimin e sistemit shëndetësor, si një kompani me përgjegjësi sociale, UNIQA në bashkëpunim me Kryqin e Kuq (Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit) të Republikës së Maqedonisë në ambientet e Shoqërsisë organizon aksion për dhurim të gjakut.

Unë personalisht ndjem krenar për një kolektiv me një ndërgjegjësim të lartë të solidaritetit të cilët tregojnë anën e tyre humane duke dhuruar pika gjaku të cilat për dikë do të thonë jetë! Aksionet e dhurimit të gjakut janë bërë traditë në ambientet tona, 2 herë në vit, me pjesëmarrjen e punonjësve të Shoqërisë së sigurimeve UNIQAAD dhe UNIQA Life.

Ne në UNIQA e shohim përfitimin e aktiviteteve me përgjegjësi shoqërore në angazhimin e përhershëm të kolektivit dhe zhvillimin e një ndërgjegjësimi të tillë - jo vetëm në kompani por edhe në nivel individual. Nuk është sekret që punonjësit e kënaqur dhe të motivuar janë jashtëzakonisht të rëndësishëm për funksionimin e suksesshëm të një kompanie, dhe punonjësit tanë rregullisht dhe me entuziazëm të pambuluar marrin pjesë në aksione të shumta” tha mes tjerash drejtori Azizi.



Koncerti i tretë i festivalit të muzikës kamertale “Skupi KamerFest”

UNIQA i ka dhënë vulën e saj afirmimit të artit duke sponsorizuar vazhdimisht fusha të ndryshme të krijimit artistik. Koncerti i tretë i festivalit të muzikës kamertale “Skupi KamerFest” ka sjell para publikut shkupjan pianistin italian Alberto Ferro, së bashku me grupin “Camerata Balcanica”. Kjo ngjarje e rëndësishme kulturore për Maqedoninë e Veriut mundësohet nga kompania e sigurimeve “UNIQA Maqedoni”. “Skupi KamerFest” mbledh artist instrumentist ndërkombëtare dhe vendor të cilët interpertojnë vepra të muzikës kamertale ku gjuha e përbashkët është muzika. Ky festival në sferën e muzikës klasike është një mini ambasadorë i cili organizon një propagandë të mirë dhe pozitive për kultën e vendit.



Mbështetje për maratonën “ColorRun” - Shtator, 2022

Për herë të parë në Maqedoninë e Veriut, u zhvillua maratona “KoloRRun”, një ngjarje unike që synon të bëjë bashkë shëndetin, lumturinë dhe individualitetin. “UNIQA Macedonia”, në kuadër të përgjegjësisë sociale që ka mbi komunitetin ishte sponsor gjeneral i aktivitetit ku morën pjesë mijëra qytetarë.

Shëndeti dhe lumturia e qytetarëve janë prioritet i “UNIQA Macedonia” ndaj kompania ka ardhur pranë tyre me produkte siguracioni që e mundësojnë diçka të tillë... Me këtë garë u përpoqëm të promovojmë disa nga shprehitë e shëndetshme që duhet t’i praktikojmë të gjithë duke dëshmuar se konkurrenca dhe gara janë të rëndësishme, por e rëndësishme është edhe miqësia apo shoqërimi së bashku!” thotw Driton Azizi, drejtor i Uniqa Maqedoni.



Si shoqëri sigurimesh, ne jemi përgjegjës për cilësinë e lartë të shërbimeve dhe aktiviteteve tona të përditshme. Ne e dimë shumë mirë se përgjegjësia jonë shkon përtej këtyre kufijve, sepse ne duam të jemi qytetarë të përgjegjshëm dhe të kontribuojmë në komunitetet në të cilat kryejmë aktivitetet tona afariste dhe jetojmë.

Që nga themelimi e deri më sot, biznesi me përgjegjësi shoqërore përfaqëson angazhimin strategjik të Shoqërisë së sigurimeve UNIQA në Maqedoni. Ne i qasemi kësaj detyre shumë të rëndësishme për ne, me shumë dashuri, mirëkuptim dhe përkushtim.

Çdo vendim që marrim, çdo projekt që mbështesim, çdo sjellje që inkurajojmë, të gjitha synojnë një qëllim: ruajtjen e ekuilibrit midis shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë, sepse ne vërtet besojmë se jetojmë më mirë së bashku.

UNIQA do të vazhdojë edhe në të ardhmen me mbështetjen e aktiviteteve me përgjegjësi shoqërore, do të monitorojmë dhe dëgjojmë me kujdes nevojat e komunitetit në të cilin operojmë, duke u përpjekur të përgjigjemi në mënyrë adekuate, në kohë dhe në interesin më të mirë të njerëzve në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme shoqërore.

UNIQA Maqedoni

Jetojmë më mirë së bashku

